



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:285288

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05511393

CAP.nr.1177/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, e përbërë nga gjykatësi individual Dr.sc. Rafet Haxhaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit "M..." me seli në Mitrovicë, kundër debitorit F. B me adresë në Mitrovicë, për shkak të borxhit, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga debitori, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë PPP.nr.376/2022 të datës 22.05.2023, me datë 26.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa e debitorit F. B nga Mitrovica si e pa bazuar, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë PPP.nr.376/2022 i datës 22.05.2023, VËRTETOHET.

Arsyetim

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, aprovohet pjesërisht prapësimi i debitorit F. B me adrese në Mitrovicë, anulohet pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.1502/2022, i datës 08.12.2022, për detyrimet që rrjedhin për periudhën kohore prej datës 01.10.2020 e deri më datën 31.10.2022, në shumën prej 179.56 €. Mbetet në fuqi pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e Përmbarimit P.nr.545/2022, i datës 09.12.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat I. M, me seli në Mitrovicë, në pjesën për përmbarimin e detyrimit të debitorit F. B, ndaj kreditorit "M..." me seli në Mitrovicë, për borxhin kryesor për shfrytëzimin e ujësjellësit dhe shërbimeve të kanalizimit për periudhën kohore prej datës 01.01.2021 deri me datën 31.10.2022, në shumën prej 619.48€, së bashku me kamatëvonesën të llogaritur mbi këtë shumë, sipas normës vjetore të interesit prej 8%, nga data e paraqitjes së propozimit datës 08.12.2022, e deri në pagesën definitive të detyrimit, te gjitha këto brenda afrit 7 ditor nga pranimi i këtij aktvendimi, nën kërcënimin e përmbarimit te detyrueshëm.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur debitori për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit, të anulohet aktvendimi i atakuar dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se kreditori "M..." ka parashtruar propozim për Lejimin e Përmbarimit, kundër debitorit F. B, për pagesën e borxhit në emër të ujit të harxhuar në shumën 799.04€.

Përmbaruesi Privat I. M, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të ekstraktit nga librat afariste, lidhur me borxhin në shumën prej 799.04 €, të krijuar për shkak të mos pagesës së furnizimit me ujë.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit në afat ligjor debitori ka paraqitur prapësim përmes të cilit ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarues duke theksuar se borxhi është i parashkruar konform nenit 360 të LMD-së.

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim dhe e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pabazuar, dhe ka kërkuar që të refuzohet prapësimi i debitorit. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar me ankesë.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe gjykatësi i vetëm i Gjykatës së Apelit, për arsye se, aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës dhe se me rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykatësi i vetëm i Gjykatës së Apelit vlerëson se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete për një vendosje të këtillë bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje përmbarimore. Nga aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe nga shkresat e lëndës, shihet se kreditori me propozimin e parashtruar me datën 08.12.2022, ka kërkuar borxhin për periudhën kohore prej 01.10.2020 deri më 31.10.2022 në shumën prej 799.04 €. Ndërsa nga kartela financiare e kreditorit borxhi për periudhën 01.01.2013 deri me 31.10.2022, gjyqtari individual gjen se borxhi

për këtë periudhë është në shumën 619.48€. Nga të lartcekurat gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit ka aprovuar vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, si në dispozitivin e të njëjtit.

Pretendimet e debitorit gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit i ka refuzuar si të pa bazuara për faktin se kreditori me debitorin kanë arritur marrëveshje për ri programimin e borxhit në 36 këste mujore dhe bazuar në nenin 368 të LMD-së, në këtë rast është bërë ndërprerja e parashkrimit. Gjyqtari i vetëm gjithashtu gjen se në shkresat e lëndës dhe Kartela e konsumatorit, nuk rezulton ndonjë gjendje tjetër borxhi nga ajo që është vendosur si në aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa debitori nuk ka argumentuar me prova mbështetëse thëniet e tij të shprehura në ankesë. Në nenin 319.1 të LPK-së është parashikuar që: *“Secila nga palët ka për detyrë që të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*. Për këto arsye ka vendosur që ankesat e parashtruara të refuzohen në tërësi si të pa bazuara dhe që aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjykatësit individual në shkallë të dytë bazohet edhe në dispozitën e nenit 3 par.2. të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerrë gjykatësi individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 par.1 pik b) të LPK-së lidhur me nenin 17 dhe 3.2 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CAP.1177/2023, me datë 26.03.2024.

GJYKATËSI,
Dr.sc. Rafet Haxhaj